



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË**  
**INSPEKTORATI SHTETËROR TEKNIK DHE INDUSTRIAL**  
**DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE TË BRENDSHME**

**NJOFTIM**

Në zbatim të Ligjin Nr. 7961, datë 12.07.1995, “Kodi i Punës së Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, Ligjit Nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, VKM Nr. 410, datë 13.05.2015 “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial”, Urdhrit të Kryeministrit Nr.105 datë 13.08.2020 "Për miratimin e Strukturës dhe Organikës së Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial", i ndryshuar Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial, shpall njoftimin për vendin vakant të punës në pozicionin:

***Specialist në Sektorin e Ankimimeve, në Drejtorinë e Çështjeve Juridike, pranë Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial***

Aplikantët që paraqesin aplikimet e tyre duhet të bëjnë kërkesë me shkrim për punësim pranë ISHTI-t. Bashkëlidhur shkresës aplikanti duhet të dorëzojë edhe dokumentet e nevojshme për aplikim. Aplikimi mund të bëhet edhe nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të institucionit.

Dokumentet për aplikim që duhet të depozitohen nga aplikuesit janë si më poshtë:

- *Fotokopje kartës së identitetit/pasaportës;*
- *Curriculum Vitae;*
- *Fotokopje e noterizuar e diplomës dhe librezës së notave;*
- *Fotokopje të çertifikatave/dëshmime/diplomave të kualifikimit;*
- *Numër kontakti/adresa e plotë e vendqëndrimit.*

***\* (Mosparaqitja e plotë e dokumenteve brenda 5 (pesë) ditëve nga data e shpalljes së Njoftimit sjell skualifikim të kandidatit).***